



**ZBATIMI I NJË INTERVENIMI EFEKTIV DHE TË DOBISHËM PËR PACIENTËT
ME ÇRREGULLIME PSIKOTIKE NË VENDET ME TË ARDHURA TË ULËTA
DHE MESATARE NË EVROPËN JUG-LINDORE**

(Studimi IMPULSE - 779334)

Pakoja Startuese e Klinicistit

Shkurt, 2019

DETAJET KONTAKTUESE TË EKIPIT HULUMTUES

SHTETI: KOSOVË

HULUMTUESI KRYESOR (ALIRIZA ARËNLIU): EMAIL: ALIRIZA.ARËNLIU@UNI-PR.EDU

HULUMTUESIT (EMRAT DHE KONTAKTET):

DASHAMIR BËRXULLI: DASHAMIR.BËRXULLI@UNI-PR.EDU

FITIM UKA: FITIM.UKA@UNI-PR.EDU

JON KONJUFGA: JON.KONJUFGA@UNI-PR.EDU

Contents

1. Pikat kyçe që duhen kujtuar	3
2. Udhërrëfyes teknik për përdorimin e aplikacionit DIALOG+	4
Shkarkimi i Aplikacionit DIALOG në tablet që operon me Android:	4
3. Pyetje të shpeshta për DIALOG+	6
Vlerësimi me pikë në shkallën DIALOG+	6
Ekрани i përzgjedhjes	6
Ekрани i diskutimit.....	7
Rivendosja e fjalëkalimit	8
4. Sllajdet PowerPoint nga trajnimi	9
5. Shembuj të ushtrimeve dhe linqe për video të trajnimit	15
6. Tabelat e veprimit të shpejtë nga Strategjia e Implementimit.....	17
Tabela 1. Udhërrëfyes për politikbërësit dhe menaxhuesit e shërbimeve të cilët e implementojnë DIALOG+	17
Tabela 2. Udhërrëfyes për klinikistët që e ofrojnë trajtimin DIALOG+ për pacientët	18
Tabela 3. Udhërrëfyes për klinikistët që u ndihmojnë pacientëve të përdorin DIALOG+	19
Table 4. Udhërrëfyesi për kujdestarët dhe anëtarët e familjes që janë të përfshirë në DIALOG+ ...	20
7. Materiale shtesë për të ndihmuar me veprimet	21
Materiale për lexim për politikbërësit, menaxhuesit e shërbimeve dhe për klinikistët	21
Shembuj të instruksioneve teknike që duhet të vendosen në tablet	22
Shembuj të fjalive që ua kujtojnë klinikistëve se çfarë kanë bërë gjatë trajnimit	23
Shembuj të citateve nga përvojat pozitive të pacientëve me DIALOG+	24
Lista e aktiviteteve që lidhen me punën.....	25
8. Referenca	25

1. Pikat kyçe që duhen kujtuar

1. Klinikistët duhet të rishikojnë veprimet që janë vendosur gjatë sesionit të kaluar (duke filluar nga sesioni i dytë).
2. Pacientët duhet ta vlerësojnë kënaqshmërinë e tyre në 11 domenet.
3. Klinikistët duhet të pyesin nëse pacienti ka nevojë për më shumë ndihmë në 11 domenet.
4. Klinikistët duhet të krahasojnë disa nga vlerësimet e domeneve me vlerësimet nga sesionet e kaluara.
5. Klinikistët duhet të përdorin përforsimin pozitiv apo të tërheqin vëmendjen e pacientit drejt përmirësimit të kënaqshmërisë me disa nga domenet, në mënyrë që të fillojë biseda rreth asaj që po funksionon.
6. Klinikistët dhe pacientët duhet të selektojnë së bashku të paktën një domen për ta rishikuar në sesionin e pare ose të paktën tre domene në sesionet e radhës.
7. Klinikistët dhe pacientët duhet të diskutojnë mbi vlerësimet dhe mbi atë që po funksionon në domenin e përzgjedhur.
8. Klinikistët dhe pacientët duhet të diskutojnë apo të imagjinojnë “rastin më të mirë” në këto domene dhe të marrin parasysh përmirësimet e vogla dhe kuptimplota në situatën e aktuale të një domeni.
9. Klinikistët duhet t’i inkurajojnë pacientët që të marrin parasysh veprime të mundshme që mund të ndërmerren nga 3 palët e përfshira (pacientët, klinikistët apo personat e tjerë) për të arritur ndryshimet e dëshiruara në domenin e përzgjedhur.
10. Klinikistët dhe pacientët duhet të pajtohen pMr veprimet që duhen ndërmarrë dhe se kush do t’i ndërmarrë këto veprime në domenet e përzgjedhura.
11. Klinikistët duhet të shkojnë nëpër qasjen 4 hapëshe siç specifikohet në manual për secilin domen të përzgjedhur.
12. Klinikistët duhet të përmbledhin dhe të regjistrojnë shkurtimisht dhe qartë veprimet për të cilat janë dakorduar me pacientin në fund të sesionit.
13. Klinikistët dhe pacientët duhet ta ndajnë mes vete tabletin gjatë shumicës së kohës.

2. Udhërrëfyes teknik për përdorimin e aplikacionit DIALOG+

DIALOG+: Fillimi i punës

Shkarkimi i Aplikacionit DIALOG në tablet që operon me Android:

1) **SHKONI TEK** [Google Play Store](#) DHE **KËRKONI** [DIALOG](#).

Ka shumë aplikacione që quhen DIALOG, por ju kërkoni aplikacionin që është zhvilluar nga Damibu Ltd, ose kërkoni drejtpërdrejt për '[DIALOG Damibu](#)'.

2) **SELEKTONI** aplikacionin DIALOG të cilin e ka krijuar '[Damibu](#)' (llogu e kaltër me një ballon të bardhë)

3) **KLIKONI** '[Install](#)'

4) Aplikacioni do të shkarkohet dhe do të shfaqet butoni 'Open'. **KLIKONI** 'Open'.

5) Ju do të vazhdoni tek aplikacioni dhe do të kërkohet që ta **SELEKTONI** një gjuhë.

Nëse kjo nuk ndodh, sigurohuni që gjuha e tabletit tuaj është gjuha juaj amtare; kjo realizohet tek opcioni "Settings" në tabletin tuaj.

Tani DIALOG+ duhet të jetë në gjuhën tuaj amtare sa here që të hyni në aplikacion.

6) Nga ju do të kërkohet që të **KRIJONI** një [Llogari](#).

Kjo gjë e kërkon një adresë valide të emailit dhe një fjalëkalim që duhet të përmbajmë: mbi 6 karaktere; një numër; një shkronjë të vogël shtypi; një shkronjë të madhe shtypi; një symbol dhe asnjë hapësirë. Simboli **#** nuk pranohet.

Ju lutem sigurohuni që të **mos ketë hapësira në fund** të emailit që e shkruani. Pastaj, **KLIKONI** '[Enter](#)'.

Nëse tableti do të përdoret nga disa persona, atëherë sigurohuni që fjalëkalimi të jetë i ditur nga të gjithë ata që kanë nevojë.

7) Në këtë fazë, sigurohuni që të gjitha opsionet e rëndësishme të DIALOG+ të jenë active. Ju mund t'i aktivizoni këto opsione sa here që dëshironi duke shkuar **SHKUAR** tek pamja kryesore e aplikacionit DIALOG+, duke gjetur opsionin '[Kolapsoni menyne](#)' në pjesën lart djathtas, duke klikuar '[Opcionet](#)' dhe duke u siguruar që opsionet '[DIALOG+](#)' dhe '[Ndihmë](#)'



'Collapse Menu' button

Shtesë' të jenë të **AKTIVIZUARA**. Nëse kutitë shënohen me ngjyrë të kaltër, kjo do të thotë që ato janë të aktivizuara.

- 8) Tani mund të **SHTONI pacientë** dhe t'i **STARTONI sesionet** e DIALOG+.

Butoni '**Shto**' në pjesën lart djathtas duhet të shtypet për të **SHTUAR** një pacient të ri në sistem.

Në pamjen kryesore të aplikacionit DIALOG+ paraqitet lista e pacientëve që janë shtuar më parë.

Pasi që e shtoni një pacient, për secilin session të ardhshëm me pacientin e njëjtë klikoni emrin e pacientit tek butoni "Terminet" në pamjen fillestare të aplikacionit. Pastaj klikoni 'Sesion i ri'.

- 9) Për t'u siguruar që tableti nuk mbyllet automatikisht gjatë seancës, ju lutem **CAKTONI** opcionin **Auto-Lock** si '**Never**' në **Opcionet e tabletit tuaj**.

3. Pyetje të shpeshta për DILAOG+

Vlerësimi me pikë në shkallën DIALOG+

1. Kam vlerësuar shkallën për një nga domenet, por nuk më lejon të vazhdoj tutje. Aplikacioni nuk ju lejon të kaloni në artikullin tjetër derisa pyetja "A keni nevojë për më shumë ndihmë në këtë fushë?" të ketë marrë përgjigje. Thjesht klikoni 'Po' ose 'Jo' poshtë pyetjes për t'ju lejuar të vazhdoni me vlerësimin.

2. Vlerat në shkallë, p.sh. Plotësisht i pakënaqur, nuk shfaqen në ekran. Pacienti nuk është i sigurt se çfarë donë të thonë numrat.

Shpjegimet e vlerësimeve, pra totalisht të pakënaqur, në mes, shumë të kënaqur etj., Shfaqen vetëm kur tableti vendoset në pamjen e peizazhit. Duke e kthyer tabletin për 90 shkallë dhe duke e vendosur tabletin në pamjen e peizazhit, shpjegimet e vlerësimit do të shfaqen automatikisht. Prandaj rekomandohet që në sesionet e para shkalla DIALOG të kompletohet në pamjen e peizazhit derisa pacienti të njihet me shkallën dhe vlerësimet gjegjëse.

Përveç kësaj, sigurohuni që opcioni i rrotullimit të ekranit në tabletin tuaj të mos jetë i ngrirë. Si ta bëni këtë do të varet nga modeli i tabletit që e përdorni.

3. Teksti është shumë i vogël; pacienti nuk mund ta shohë shkallën.

Madhësia e tekstit brenda aplikacionit DIALOG + mund të rregullohet duke ndryshuar opsionet e vetë tabletit. Si ta bëni këtë ndryshon në varësi të modelit të tabletit.

Ekрани i për zgjedhjes

1. Kur provoj të për zgjedh një domen për diskutim të mëtejshëm, aplikacioni kthehet në ekranin e 'Rishikimit'.

Për të zgjedhur një artikull / domen për diskutim të mëtejshëm (dhe për të aplikuar qasjen 4 hapëshe) duhet të zgjidhni vetëm atë artikull. Kur të hyni në ekranin 'Për zgjedh', artikujt e listuar shndërrohen në butona (dhe shënohen me ngjyrë të kaltër). Klinikisti tani mund të zgjedhë artikujt që ata dhe pacienti kanë vendosur të diskutojnë më tej, gjë që i selekton ato dhe i vendos në "rendin e ditës" për pjesën e mbetur të sesionit.

Nëse shtypni diçka tjetër përpos butonit, për shembull nëse shtypni shkallën, aplikacioni automatikisht do t'ju kthejë një fazë në ekranin e Rishikimit. Nëse kjo ndodh atëherë lutemi të shkoni përsëri në ekranin 'Për zgjedh' dhe shtypni artikullin që kërkon diskutim të mëtejshëm.

2. Opcioni për krahasim nuk funksionon dhe shfaqen vetëm vlerësimet e sesionit të tanishëm (vijat e kaltra).

Vijat e kaltra në ekranin e Përzgjedhjes tregojnë vlerësimet që janë dhënë nga pacienti në sesionin e tanishëm. Nëse nuk shfaqen linja portokalli, pas zgjedhjes së një kutie në krye të ekranit ku figurojnë datat e mëparshme të vlerësimit, atëherë ka të ngjarë që nuk janë dhënë vlerësime për ato domene në sesionet e kaluara.

Ekрани i diskutimit

1. I kam selektuar tre domene për diskutim të mëtejshëm, por shfaqet vetëm njëri.

Kur përzgjidhet më shumë se një domen për diskutim të mëtejshëm, atëherë qasja 4 hapëshe duhet të zbatohet për çdo domen individualisht. Duke lëvizur djathtas tek ekranin 'Diskuto', klinicisti mund të lëvizë nëpër të gjitha domenet e përzgjedhura dhe të shohë vlerësimin përkatës të kënaqshmërisë në krye të ekranit.

2. Kur vendosen veprimet e dakorduara, a duhen vendosur ato individualisht apo të gjitha njëherësh?

Kjo është preferencë personale, dhe klinicisti mund të vendosë nëse do ta vendosë çdo veprim të dakorduar individualisht ose së bashku si listë rendore.

3. Çfarë është funksioni i butonit 'i' në anën e djathtë të ekranit?

Nëse shtypen një here butonat 'i', ato e shfaqin një shpjegim të zgjeruar të asaj që duhet të bëhet në secilin prej 4 hapave. Ky shpjegim kopjohet direkt nga manuali DIALOG dhe jep shembuj të pyetjeve që klinicisti mund të përdorë për të nxjerrë informacion apo ide nga pacienti. Duke shtypur butonin e kthimit prapa në tablet do të ktheheni në ekranin 'Diskuto'.

4. Pacienti e ka vlerësuar njërin domen me numrin 1 ('plotësisht i pakënaqur'), prandaj nuk mund ta shtrojë pyetjen "Pse ky vlerësim dhe jo ndonjë më i ulët?" tek hapi 1 në qasjen 4 hapëshe.

Një pjesë e rëndësishme e terapisë së fokusuar në zgjidhje është identifikimi dhe përdorimi i resurseve ose strategjive që i përdorin pacientët, ndoshta pa vetëdije dhe në domene të ndryshme të jetesës, të cilat mund të përdoren për të rritur kënaqshmërinë brenda fushës së diskutimit. Duke pyetur "pse ky vlerësim dhe jo ndonjë më i ulët?", ju përpiqeni t'ia transmetoni pacientit idenë se kënaqshmëria do të mund të ishte më e ulët dhe mund të ketë gjëra që po funksionojnë mirë aktualisht.

Nëse pacienti e vlerëson domenin me numrin 1 ("krejtësisht i pakënaqur"), atëherë klinicisti mund të nënvizojë faktin që pacienti është i motivuar t'i ndryshojë gjërat me vetë faktin që merr pjesë në seancë dhe që po i diskuton problemet me një profesionist të shëndetit mendor.

5. E kam përmbyllur qasjen 4 hapëshe për të gjitha domenet e selektuara dhe i kam vendosur veprimet e dakorduara në aplikacion. Çfarë të bëj tani?

Pasi që të futen në aplikacion veprimet e dakorduara, klinicisti duhet të shtypë butonin "Kthehu" për t'u kthyer një hap (ky është butoni fizik dhe jo ndonjë buton në ekranin e aplikacionit)



Rivendosja e fjalëkalimit

1. Nuk pranoj email kur e rivendos fjalëkalimin.


Ju lutemi sigurohuni që tableti juaj është i lidhur me internetin kur përpiqeni të rivendosni fjalëkalimin tuaj.

4. Sllajdet PowerPoint nga trajnimi

<p>1</p> <p style="text-align: center;">Intervenimi i DIALOG+</p>	<hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/>												
<p>2</p> <p style="text-align: center;">Pilot studimi</p> <ul style="list-style-type: none"> • Intervenimi DIALOG+ në pilot studim do të përfshijë një çift prej 5 klinikistësh dhe pacientësh në secilin vend pjesëmarrës • Intervenimi DIALOG+ dhe manuali i tij do të përkthehen në gjuhët lokale • Feedbacku i marrë nga fokus grupet do të përfshihet në materialet finale për studimin implementues 	<hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/>												
<p>3</p> <p style="text-align: center;">Pyetjet e DIALOG+</p> <ul style="list-style-type: none"> • “Sa të kënaqur jeni ju me...” <table border="0" style="margin-left: 20px;"> <tr> <td>shëndetin mendor</td> <td>shëndetin fizik</td> </tr> <tr> <td>punën</td> <td>akomodimin</td> </tr> <tr> <td>aktivitetet e kohës së lirë</td> <td>partnerin/familjen</td> </tr> <tr> <td>miqtë</td> <td>sigurinë personale</td> </tr> <tr> <td>medikamentet</td> <td>ndihmën praktike që merr</td> </tr> <tr> <td>takimet</td> <td></td> </tr> </table> • Vlerësimi i secilës fushë nga 1 në 7 • ‘A ju duhet më shumë ndihmë në këtë fushë?’ 	shëndetin mendor	shëndetin fizik	punën	akomodimin	aktivitetet e kohës së lirë	partnerin/familjen	miqtë	sigurinë personale	medikamentet	ndihmën praktike që merr	takimet		<hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/>
shëndetin mendor	shëndetin fizik												
punën	akomodimin												
aktivitetet e kohës së lirë	partnerin/familjen												
miqtë	sigurinë personale												
medikamentet	ndihmën praktike që merr												
takimet													
<p>4</p> <p style="text-align: center;">IMPULSE</p> <ul style="list-style-type: none"> • Implementimi i intervenimit DIALOG+ për pacientët me çrregullime psikotike në 5 vende të Evropës Juglindore • Ofrimi i një intervenimi që kushton pak, është i përgjithshëm dhe efektiv për vendet me të ardhura të ulëta dhe mesatare • IMPULSE ka për qëllim që të përmirësojë në mënyrë radikale kujdesin ndaj personave me sëmundje mendore serioze 	<hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/>												

<p>5</p> <p style="text-align: center;">Shkallët e DIALOG+</p> <ul style="list-style-type: none"> • 8 qëndrime (ajtime) – matje subjektive e shkëlqyeshme e kualitetit të jetës • 3 qëndrime (ajtime) – matje e mirë e satisfaksionit me trajtimin • Interpretim i drejtëpërdrejtë • Secili ajtem i plotëkuptimtë • I preferuar në raport me shkallët e tjera • Përdorimi në rritje për matjen e rezultateve • Interpretim për shërbimet individuale apo të pacientëve 	<hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/>
<p>6</p> <p style="text-align: center;">Zhvillimi I DIALOG+</p> <p>DIALOG+ mbështetet në :</p> <ul style="list-style-type: none"> • Huluntimin e kualitetit të jetës • Konceptet e komunikimit me pacientin në qendër • Zhvillimet e teknologjisë informative • Terapinë e fokusuar në zgjidhje 	<hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/>
<p>7</p>  <p>How satisfied are you with your mental health?</p> <p>1 2 3 4 5 6 7</p> <p>totally dissatisfied very dissatisfied fairly dissatisfied in the middle fairly satisfied very satisfied totally satisfied</p> <p>Do you need more help in this area? <input type="checkbox"/> No <input type="checkbox"/> Yes</p> <p>Physical health _____</p> <p>Job situation _____</p> <p>Accommodation _____</p> <p>Leisure activities _____</p> <p>Partner / family _____</p> <p>Friendships _____</p> <p>Personal safety _____</p> <p>Medication _____</p> <p>Practical help _____</p> <p>Meetings _____</p>	<hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/>
<p>8</p>  <p>Assessment</p> <p>Nov 11 December 2015 Thursday, 10 February 2016 Wednesday, 3 August 2016 Friday, 10 October 2016 Overall Performance</p> <p>Mental health 1 2 3 4 5 6 7</p> <p>Physical health 1 2 3 4 5 6 7</p> <p>Job situation 1 2 3 4 5 6 7 ✓</p> <p>Accommodation 1 2 3 4 5 6 7</p> <p>Leisure activities 1 2 3 4 5 6 7</p> <p>Partner / family 1 2 3 4 5 6 7</p> <p>Friendships 1 2 3 4 5 6 7 ✓</p> <p>Personal safety 1 2 3 4 5 6 7</p> <p>Medication 1 2 3 4 5 6 7 ✓</p> <p>Practical help 1 2 3 4 5 6 7</p> <p>Meetings 1 2 3 4 5 6 7</p>	<hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/>

9




10



11



12



13

<p style="text-align: center;">Studimi DIALOG+</p> <ul style="list-style-type: none"> • Studim me grup të randomizuar të kontrollit • 40 klinicistë me 180 pacientë • DIALOG+ kundrejt grupit të kontrollit • Periudhë e intervenimit prej 6 muajsh • Progresi vlerësohet në fillim, pas 3 muajsh, 6 muajsh, dhe 12 muajsh 	<hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/>
<p>14</p> <p style="text-align: center;">Rezultatet e provave të DIALOG+ në Britani</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përmirësim i kualitetit të jetës • Zvogëlim i simptomave të përgjithshme • Më pak nevoja të papërbushura pas 3 dhe 6 muajsh • Situatë më e mirë sociale përgjatë 1 viti • Kursime në kujdesin shëndetësor përgjatë 1 viti 	<hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/>
<p>15</p> <p style="text-align: center;">Përvojat e pacientëve</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>“Pyetjet... më kanë shtyrë që të shikoj jetën time dhe të reflektoj mbi të... Më pare nuk i kam adresuar çështjet që janë shfaqur gjatë implementimit të DIALOG+”</i> • <i>“Ti fillon që ta përmirësosh veten pasi që tani je i vetëdijshëm për këtë... Më ka bërë të kuptoj se çfarë duhet të bëj”</i> • <i>“DIALOG+ ishte më i strukturuar, më profesional, më i fokusuar... Po bëja gjëra konkrete për çështje konkrete”</i> 	<hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/>
<p>16</p> <p style="text-align: center;">Përvojat e klinicistëve</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>“Ka qenë i strukturuar dhe ka qenë e lehtë për ta që të përcjellin se për çfarë po flasim”</i> • <i>“Tani unë mund të nxjerr më shumë informata nga ai”</i> • <i>“Për mua ka qenë mjeti më fuqizues në 10 vitet që kam punuar si klinicist. Definitivisht e ka ndryshuar marrëdhënien terapeutike... Në fund të trajtimit ai është kujdesur për veten plotësisht”</i> 	<hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/>
<p>17</p>	<hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/>

<p>Pse ky intervenim është efektiv?</p> <ul style="list-style-type: none"> • Adreson shqetësimet që zgjedhin vetë pacientët • Fuqizon pacientët • Ndhimohet komunikimi terapeutik 	<hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/>
<p>18</p> <p>Disponueshmëria</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të gjitha informatat gjenden tek http://dialog.elft.nhs.uk • Aplikacione pa pagesë për të gjithë hapat e DIALOG+ • Për platformat iPad dhe Android • Platforma e të mësuarit elektronik pa pagesë 	<hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/>
<p>19</p> <p>Parime implementuese</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësim, planifikim dhe intervenim në një procedurë të vetme • Parime të qarta • Qëlimisht një manual i shkurtër • Fkesibilitet në sesione (p.sh. Adreson më shumë se sa një çështje në një kohë). • Përdorim i rregullt deri sa të lirohet pacienti 	<hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/>
<p>20</p> <p>Implementimi (II)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të mësuarit e parimeve dhe hapave bazë • Përvoja praktike • Fidbeku dhe improvizimi • Stili personal • Të mësuarit për klinikistin dhe pacientin 	<hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/>
<p>21</p>	<hr/> <hr/> <hr/> <hr/>

<p>Video demonstrim</p>	<hr/> <hr/> <hr/> <hr/>
<p>22</p> <p>Praktikimi i roleve</p> <ul style="list-style-type: none"> • Tani ndanu në grupe ku njëri e luan klinikistin dhe grupi tjetër e luan pacientin • Personat e tjerë mund të observojnë dhe të japin opinione • Pas 10 minutash, ndërrohuni dhe vazhdoni me një ushtrim tjetër • Pastaj diskutoni se çfarë shkoi mire dhe se çfarë shkoi keq, çfarë ishte sfiduese 	<hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/>

5. Shembuj të ushtrimeve dhe linqe për video të trajnimit

Shembuj dhe ushtrime të dobishme për praktikim të roleve:

Skenari A: Pacienti dyshues

Ana është 25 vjeçe dhe ka qenë paciente në që ka marrë shërbime për pesë vjet, por tani ka filluar me DIALOG+. Ajo u diagnostikua me skizofreni paranojake dhe megjithëse kryesisht gjendet në fazën e remisionit, ajo ende i përjeton disa simptoma të paranojës. Anna dëshiron të flasë për shëndetin e saj mendor por fiksohet tek tableti që nga fillimi i seancës DIALOG+ dhe fillon të pyesë nëse biseda po regjistrohet dhe nëse ky informacion do të ndahet me dike tjetër. Ajo duket se është e shqetësuar nga tableti dhe nuk i përgjigjet pyetjeve të klinikistit.

Çështja:

- Ajo dyshon tek tableti dhe nuk mund të fokusohet tek pyetjet
- Ajo dëshiron ta menaxhojë më mire paranojën e saj sepse ia ka pamundësuar të dalë nga shtëpia.

Çfarë funksionon:

- Ajo qetësohet dhe bëhet më pak dyshuese kur klinikisti e lejon që ta mbajë tabletin dhe kur thekson faktin se çdo gjë është konfidenciale
- Në jetën e saj të përditshme, paranoja e saj është më e butë nëse me të qëndron një anëtar i familjes

Skenari më i mirë:

- Nëse ajo nuk fiksohet fare në tabletin gjatë sesioneve
- Nëse ajo mund të dalë jashtë shtëpisë në mënyrë të pavarur për një kohë të zgjatur p.sh. për të blerë gjëra, për t'u takuar me miq, për të pirë kafe

Ndryshime të vogla:

- Nëse nuk fiksohet në tabletin për më shumë se 15 minuta gjatë një sesioni
- Nëse mund të dalë jashtë shtëpisë për një kohë të shkurtër pa një anëtar të familjes

Çfarë mund të bëjë pacienti:

- T'i tregojë klinikistit nëse fillon të ketë paranojë gjatë sesioneve, në mënyrë që klinikisti të mund të ndër marrë hapa për këtë
- Organizoni një shëtitje të shkurtër jashtë shtëpisë me një anëtar të familjes

Çfarë mund të bëjë klinikisti:

- Të njohë shfaqjen e paranojës gjatë sesioneve, të tregojë mirëkuptim për pacientin dhe t'i inkurajojë që ata t'i eksplorojnë ndjenjat dhe mendimet e tyre në një mjedis të sigurt. Klinikistët nuk duhet t'i shpërfillin shqetësimet paranojake të pacientëve.

Çfarë mund të bëjnë të tjerët:

- Anëtarët e familjes mund të dalin jashtë shtëpisë me pacientin dhe ta ndihmojnë nëse ajo ka paranojë.

Skenari B: Pacienti i papunë

Marko është 35 vjeç dhe ka qenë i papunë për tre vjet. Ai ka kërkuar punë në mënyrë aktive gjatë vitit të kaluar, ka dërguar CV-në e tij, ka dërguar shumë aplikime dhe madje ka marrë pjesë në një intervistë, por nuk ka pasur sukses. Ai ka kualifikimet e nevojshme dhe është i motivuar, por dikush me psikozë shpesh konsiderohet se nuk mund të punësohet aty ku jeton. Ai ka një rreth të miqve dhe të familjes që e mbështesin shumë dhe që duan ta ndihmojnë atë të gjejë punë

Çështja:

- Mungesa e punës e bën të ndihet i papërbushur
- Ai shqetësohet për problemet me para

Çfarë funksionon:

- Ai ka dëshirë të bëjë punë vullnetare por ka pak mundësi për ta bërë këtë
- Ai merr ndonjë pagesë nga të afërmit apo miqtë kur u ndihmon në ndërtimtari apo në dekorim rreth shtëpisë, por rrallë ka nevojë për punë të tilla

Skenari më i mirë:

- Nëse e gjen një punë permanente

Ndryshime të vogla:

- Nëse kryen punë vullnetare një apo dy ditë në javë
- Nëse e gjen një ose dy mundësi për punë me pagesë

Çfarë mund të bëjë pacienti:

- Të identifikojë mundësi për punë vullnetare
- Të zgjerojë rrethin e klientëve të mundshëm duke marrë kontakte nga familja dhe miqtë

Çfarë mund të bëjë klinikisti:

- T'i ndihmojë që të identifikojë mundësi për punë vullnetare nëse kjo përbën sfidë për pacientin

Çfarë mund të bëjnë të tjerët:

- Të ndihmojë që ta shpërndajë njoftimin që pacienti ka mundësi të bëjë punë me pagesë

Linqe për ushtrime të tjera në artikullin nga Priebe et al (2017):

<https://www.ncbi.nlm.nih.gov/books/NBK424437/>

Video që tregojnë implementimin e sesioneve DIALOG+:

https://www.youtube.com/channel/UC35yy18_Go7bO2_bLZ3w9VA/playlists

6. Tabelat e veprimit të shpejtë nga Strategjia e Implementimit

Ju lutem shikoni Strategjinë e Implementimit për secilin seksion të trajtuar më poshtë.

Veprimet për akterët	
Si t'i përdorni tabelat:	
<ul style="list-style-type: none"> Shkoni tek seksioni që është relevant për rolin tuaj në implementimin e DIALOG+ Gjeni barrierën me të cilën po ballafaqoheni në kolonën e majtë Veprimi për ta tejkaluar këtë barrierë jepet në qelinë korresponduese të kolonës së djathtë 	
Tabela 1. Udhërrëfyes për politikbërësit dhe menaxhuesit e shërbimeve të cilët e implementojnë DIALOG+	
Barriera e identifikuar	Veprimi i propozuar
1. I pasigurt se si të implementohet DIALOG+	<p>Këto pika mund të adresohen në trajnimin përkujtues:</p> <p>1.a. Kërkoni që të shihni shembuj të modeleve të implementimit nga vendet e ngjashme</p> <p>1.b. Shikoni video të praktikimit të roleve sa u përket përvojave të shumëllojshme për DIALOG+, për qasjet e klinikistëve dhe për tejkalimin e dilemave, etj.</p>
2. Nuk ka tabletë	<p>2.a. Deri sa të sigurohen tabletët, klinikistët mund të përdorin tabletët e veta apo të huazuara</p> <p>2.b. Investimi në tabletë të rinj, argumentimi se kjo mund të reduktojë kostot në të ardhmen (Priebe et al., 2017; Kapitulli 5)</p>
3. Probleme organizative	<p>3.a. Nëse jeni të pasigurt se a do të përfitojë organizata nga DIALOG+: Kostot e trajtimit janë gjetur se janë më të ulëta tek pacientët që marrin trajtimin DIALOG+ në një studim në Britani të Madhe (Priebe et al., 2015), gjë që tregon se DIALOG+ mund të kursejë para në kuptimin afatgjatë.</p> <p>3.b. Nëse është e mundur, menaxhuesit mund të ndajnë kohë shtesë në planifikimin kohor për sesionin e pare të DIALOG+ (p.sh. 45 minuta). Sesionet e tjera mund të zgjatin për 30 minuta.</p> <p>3.c. Kërkoni nga klinikistët që të fokusohen në më pak domene jetësore, ashtu që sesionet e DIALOG+ të mund të mbahen në kohën e paraparë (1 në sesionin e pare, jo më shumë se 3 në sesionet e tjera)</p>
4. Burime të kufizuara njerëzore	<p>4.a. Bënk trajnimin e klinikistëve të tjerë në klinikën e njëjtë krahas psikiatërve, p.sh. infermierëve, punëtorëve socialë dhe psikologëve</p> <p>4.b. Nëse është e mundur, punësoni më shumë klinikistë. Argumentoni tek menaxhmenti që është gjetur se DIALOG+ i redukton kostot e përkujdesjes (Priebe et al., 2015 and 2017)</p>
5. Rezistencë në mesin e menaxhuesve të shërbimeve dhe klinikistëve	<p>5.a. Merrni këndvështrime positive mbi DIALOG+ nga menaxhmenti dhe klinikistët e tjerë</p> <p>5.b. Krahasoni praktikën tuaj me praktikën e shteteve të tjera të cilat janë duke e implementuar DIALOG+ dhe duke përfituar nga ai</p> <p>Nëse ka rezistencë për shkak të kohës, shih 3.b dhe 3.c.</p> <p>Nëse ka rezistencë për shkak të ndryshimit, shih 3.a. dhe trajnimet</p>

Tabela 2. Udhërrëfyes për klinikistët që e ofrojnë trajtimin DIALOG+ për pacientët	
Barriera e identifikuar	Veprimi i propozuar
<p>6. Ka nevojë për trajnim në këto domene jetësore:</p> <p>6.a. Situata e punësimit nëse pacienti është i papunë</p> <p>6.b. Partneri/familja nëse kanë vlerësime të ndryshme</p> <p>6.c. Ndhimë praktike me ekuivalentë të kufizuar</p> <p>Pyetja gjatë rishikimit të domeneve:</p> <p>6.d. A keni nevojë për më shumë ndihmë në këtë fushë?</p>	<p>6.a. Së pari pyetni pacientin nëse është i kënaqur me papunësinë Eksploroni arsyet pse duan të gjejnë punë Diskutoni se si ta përmbushni këtë nevojë nëse punë nuk është e mundur, p.sh. vullnetarizmi, aktivitetet kuptimplote që mund të gjenerojnë të ardhura, ndihma ndaj të afërmeve, etj.</p> <p>6.b. Zgjidhni domenin me kënaqësinë më të ulët dhe shënoni cili është ai</p> <p>6.c. Nëse nuk ka ekuivalentë me p.sh. qendrat e punës, përfitimet shtetërore etj., merrni parasysh çdo shërbim të jashtëm, p.sh. ndihmë në shtëpi, menaxhimin e parave, asistencë me blerjen e gjërave, etj.</p> <p>6.d. Bëni përpjekje që të mos devijoni nga ky formulim. Është menduar posaçërisht të vendosë rastin që pacientët të raportojnë nevojat për më shumë ndihmë kur është e nevojshme (Priebe et al., 2017)</p>
<p>7. Ka nevojë për trajnime praktike me tabletët dhe me aplikacionin</p>	<p>7.a. Bashkangjisni udhëzimet teknike në pjesën e pasme të tabletit dhe udhëzuesin referues në mur</p> <p>7.b. Praktikoni rolet duke përdorur tabletin, duke u siguruar që ta ndani atë me pacientin, por duke e vendosur fokusin kryesor tek pacienti dhe jo tek tableti. Shih Priebe et al (2017), Ch2, Seksioni i diskutimit në f60-62.</p>
<p>8. Besimi që DIALOG+ nuk është pjesë e rolit profesional</p>	<p>8.a. Identifikoni veten si model që implementon DIALOG+ Gjithashtu shih 12.a. për të kuptuar benefitet e DIALOG+ për pacientët</p>
<p>9. Vështirësitë në ofrimin e DIALOG+ kur pacientët janë rezistentë, shmangës, dyshues apo paranoidë</p>	<p>9.a. Shikoni shembujt e praktikimit të roleve që tregojnë se si klinikistët ofrojnë trajtimin DIALOG+ për pacientët rezistentë, shmangës, dyshues ose paranoidë (kolegët mund të përdorin shembuj nga përvoja)</p> <p>9.b. Praktikoni me shembuj të luajtjes së roleve të pacientëve të vështirë p.sh. bazuar tek përvoja ose tek Shtojca 3 në Priebe et al. (2017) (p37 për link)</p> <p>9.c. Gjatë seancave, vlerësoni nëse vështirësia ndryshon me kalimin e kohës kur ju inkurajoni pacientin para çdo sesi. Nëse dyshimi shkaktohet nga tableti, përdorni gjithashtu 20.a. në Tabelën 3.</p>
<p>10. Besimi që pacientët akutë nuk mund të marrin pjesë</p>	<p>10.a. Pacientët psikotikë që marrin DIALOG + kishin cilësi më të mirë të jetës në 3, 6 dhe 12 muaj, kishin më pak nevoja të paplotësuara në 3 dhe 6 muaj, më pak simptoma të përgjithshme psikopatologjike në të gjitha pikat kohore dhe rezultate më të mira sociale në 12 muaj (Priebe et al., 2015)</p>
<p>11. Besimi që tabletët mund të ngjallin dyshime tek disa pacientë</p>	<p>11.a. Shumica e pacientëve në studimin pilotues nuk kanë raportuar ndonjë dyshim, me përjashtim të një pacienti, kështu që kjo mund të mos përbëjë problem në praktikë. Dyshimi ndaj tabletëve u kapërcye në një studim të mëparshëm duke ndarë tabletin (Priebe et al., 2017).</p>
<p>12. Besimi që DIALOG+ ka efekte të tjera negative p.sh. qasja përmes detyrave, efektet negative tek bisedat</p>	<p>12.a. Shumica e klinikistëve dhe pacientëve nga studimi pilotues raportojnë se DIALOG+ ka përmirësuar bisedat e tyre (shih Seksionet 5.2.1.1 në f17 dhe 5.3.1.1 në f22 të Strategjisë së Implementimit).</p> <p>12.b. Çdo problem me bashkëbisedimin mund të ndodhë për shkak të mungesës së trajnimeve. Rilexoni Manualin dhe shihni 7.a. për ta bërë komunikimin më në përputhje me synimet e DIALOG+.</p>
<p>13. Ofrimi i DIALOG+ kërkon sforcim mendor</p>	<p>13.a. vendosni fjalë për rikujtime në tablet, apo shënime në mur, për të kujtuar se çfarë është bërë gjatë trajnimit</p>
<p>14. Koha e kufizuar</p>	<p>Kompletoni të gjithë trajnimin, pasi që ofrimi efikas i intervenimit do të ulë kohën e kërkuar.</p> <p>14.a. Diskutoni vetëm 1 domen në sesionin e parë, pasi do të zgjasë më shumë. Ngritni numrin e domeneve kur të mësoheni me DIALOG+. Diskutoni jo më shumë se 3 fusha nëse nuk ju premtan koha. 1-2 domenet duhet të marrin 30 minuta dhe 3</p>

	domenet duhet të marrin 45 minuta. 14.b. Matni kohën që ju merr ofrimi i DIALOG+ tek një koleg, dhe pastaj provoni ta shkurtoni këtë kohë.
15. Resurset e kufizuara ekonomike që e pengojnë progresin në këto domene	Shih 6 .
16. Ata dëshirojnë të përzgjedhin pacientë që mendojnë që do të jenë të përshtatshëm për DIALOG+	Shih 11.a .

Tabela 3. Udhërrëfyes për klinikistët që u ndihmojnë pacientëve të përdorin DIALOG+	
Barriera e identifikuar	Veprimi i propozuar
17. Pacientët ndihen më pak kompetentë	<p>17.a Inkurajoni pacientët në fillim të seancës që ata të mund të performojnë mirë - shih Manualin për skriptat e sugjeruara.</p> <p>17.b. Në fillim bëni detyrat më të lehta, pastaj rrisni vështirësitë, p.sh. nëse vlerësohet 2, skenari më i mirë mund të jetë 5 në vend të 7 dhe pastaj të punojë për 3. Në fillim bini dakord për më pak veprime dhe me ndryshime më të vogla</p> <p>17.c. Kërkoni nga pacienti që të mendojë për sukseset e mëparshme me DIALOG+ p.sh. vlerësime të përmirësuara, aktivitete të kryera, etj.</p>
18. Pacientët janë rezistentë	<p>18.a. Vendosni qëllime me pacientë për të kapërcyer rezistencën e tyre duke përdorur tabletin çdo herë më shumë derisa besimi i tyre të rritet</p> <p>18.b. Tregojuni pacientëve citate nga përvojat pozitive të pacientëve të tjerë me DIALOG+</p>
19. Pacientët përjetojnë sforcim mendor	<p>19.a. Jepini pacientëve një rikujtim për detyrat që duhet të bëni për seancat, p.sh. kopje fizike (foto të ekranit të tabletit ose të shkruara në një fletore), ose me tekst për të kursyer kohë.</p> <p>19.b. Ju mund të bëni tepër shumë pyetje ose të caktoni tepër shumë veprime. Vetëm fokusohuni në 1-2 tema në seancë.</p>
20. Pacientët kanë ndjenja negative	<p>20.a. Konfirmoni për pacientin që nuk ka arsye për të patur dyshim ndaj tabletit duke inkurajuar dhe ndarë tabletin dhe theksoni përfitimet e DIALOG+ për pacientët.</p> <p>20.b. Shikoni skriptet në Manual (kutitë e kaltra) për sugjerimet e gjuhës së fokusuar në zgjidhje. Mos i nënvizoni problemet tej mase.</p> <p>Shih 18.b. Shih 9.b. në Tabelën 2 - luajtja e roleve duke përdorur shembuj të përpunuar të pacientëve të vështirë për të praktikuar këto skenare</p>
21. Pacientët kanë nevojë për ndihmë që t'i kryejnë veprimet në mes të sesioneve	<p>Shih 19.a.</p> <p>21.a. Ofroni pacientëve një fletore me veprimet me shkrim, dhe kërkoni nga ta që të regjistrojnë përpjekjet në lidhje me qëllimin e tyre.</p> <p>21.b. Në fillim caktoni më pak aktivitete që duhet të përfundohen në mes të sesioneve, pastaj rritni numrin me kalimin e kohës.</p>

Table 4. Udhërrëfytyesi për kujdestarët dhe anëtarët e familjes që janë të përfshirë në DIALOG+	
Barriera e identifikuar	Veprimi i propozuar
22. Pacientët kanë nevojë për ndihmë që t'i kryejnë veprimet në mes të sesioneve	Shih 19.a. dhe 21.a. tek Tabela 3 më sipër. 22.a. Ndhmoni pacientët që t'i rikujtojnë veprimet e dakorduara.
23. Besimi që pacientët akutë nuk mund të marrin pjesë	23.a. Pacientët psikikë që marrin DIALOG+ kishin cilësi më të mirë të jetës në 3, 6 dhe 12 muaj, kishin më pak nevoja të paplotësuara në 3 dhe 6 muaj, më pak simptoma të përgjithshme psikopatologjike në të gjitha pikat kohore dhe rezultate më të mira sociale në 12 muaj (Pribe et al., 2015 dhe faja 41 për linkun me tërë artikullin)

7. Materiale shtesë për të ndihmuar me veprimet

Materiale për lexim për politikbërësit, menaxhuesit e shërbimeve dhe për klinikistët

Priebe, S., Golden, E., Kingdon, D., Omer, S., Walsh, S., Katevas, K., ... & McCabe, R. (2017).

Developing the DIALOG+ intervention. <https://www.ncbi.nlm.nih.gov/books/NBK424433/>

Kapitulli 2: Developing the DIALOG+ software

<https://www.ncbi.nlm.nih.gov/books/NBK424441/>

Kapitulli 5: Cost-effectiveness of the DIALOG+ intervention

<https://www.ncbi.nlm.nih.gov/books/NBK424426/>

Kapitulli 8: Focus groups with clinicians who delivered the DIALOG+ intervention

<https://www.ncbi.nlm.nih.gov/books/NBK424438/>

Shtojca 3: Case vignettes for DIALOG+ training

<https://www.ncbi.nlm.nih.gov/books/NBK424437/>

Priebe, S, K. L., Omer, S., Golden, E., Walsh, S., Khanom, H., Kingdon, D., Rutterford, C., McCrone, P., & McCabe, R. (2015). The Effectiveness of a Patient-Centred Assessment with a Solution-Focused Approach (DIALOG+) for Patients with Psychosis: A Pragmatic Cluster-Randomised Controlled Trial in Community Care. *Psychotherapy and Psychosomatics*, 84(5): p. 304-13. <https://www.karger.com/Article/Abstract/430991>

Shembuj të instruksioneve teknike që duhet të vendosen në tablet

Instruksione më të hollësishme mund të gjenden në pakon e klinikistit dhe në manual.

To download DIALOG+: see the instructions in the clinician's pack.

Për të startuar me DIALOG+: hapni aplikacionin dhe shkruani fjalëkalimin. Shtypni 'sesion i ri', apo për të vazhduar me një sesion të mëhershëm, selektoni datën nga lista më poshtë dhe shtypni 'vazhdo vlerësimin'.

Për ta përzgjedhur një domen: shtypni emrin e domenit nga lista në të majtë. Kjo e aktivizon domenin, me ç'rast zvogëlohen të gjitha domenet e tjera.

Për ta vlerësuar një domen: klikoni kudo që dëshironi në shkallën e vlerësimit për të përzgjedhur nivelin e kënaqshmërisë. Sapo të jepet një vlerësim, gjithashtu duhet dhënë përgjigje në pyetjen se a ka nevojë për ndihmë shtesë.

Për ta kthyer vlerësimin mbrapa: shtypni butonin e shiritit të vlerësimit deri sa të zhduket vlera.

Për ta kthyer mbrapa përgjigjen ndaj pyetjes për ndihmë shtesë: shtypni butoni po/jo.

Për t'i rishikuar domenet: klikoni 'rishiko' në pjesën poshtë djathtas në ekrane. Në kalendarin në krye të ekranit, klikoni datën e sesionit të kaluar, me të cilin dëshironi ta krahasoni këtë sesion. Vlerësimet e këtij sesioni (të kaltra) pastaj mund të krahasohen me vlerësimet e atij sesioni (portokalli).

Për ta përzgjedhur domenin për diskutim: shtypni 'Përzgjedh' në pjesën poshtë djathtas në ekran. Kjo i shndërron domenet e listuara në butone. Shtypni domenet që ju interesojnë për t'i hijezuar ato dhe pastaj shtypni butonin 'Diskuto' në pjesën poshtë djathtas në ekran. Qasja 4 hapëshe do të shfaqet tani në ekran për secilin domen me radhë.

Për t'i shtuar veprimet: klikoni '+' në ekranin 'Hapi 4 Dakordimi për veprime'. Shkruani veprimin në fushën përkaëse dhe pastaj shtypni 'shto'.

Për të lëvizur në mes të domeneve gjatë diskutimit: përdorni shigjetat në fund të ekranit për të parë qasjen 4 hapëshe për secilin domen.

Për më shumë informata: shtypni butonin (i).

Për t'u kthyer në ekranin e rishikimit: shtypni 'ok'

Për t'i rishikuar veprimet: shtypni butonin 'artikujt e veprimit' në pjesën poshtë djathtas në ekranin e rishikimit.

Për ta kryer sesionin: shtypni 'Përfundo sesionin' në pjesën poshtë djathtas në ekran.

Për problemet teknike: shihni pyetjet më të shpeshta në pakon e klinikistit.

Për detaje të mëtejshme: shih Manualin DIALOG+ në pakon e klinikistit.

Shembuj të fjalive që ua kujtojnë klinicistëve se çfarë kanë bërë gjatë trajnimit

Këto fjali e reduktojnë fokusin mendor që raportohet nga klinicistët kur ata mundohen t'i përcjellin mendimet e pacientëve të tyre gjatë sesioneve, sidomos kur kanë shumë pacientë.

Gjithashtu këtu janë përfshirë disa fjali që e përmirësojnë implementimin e DIALOG+.

Jini të vetëdijshëm që këto fjali duhen përdorur vetëm kur mund t'i shihni, dhe largoni ato pas sesionit, për shkak se klinicistët në grupin e kontrollit që nuk marrin pjesë në DIALOG+ mund të ndikohen nga to.

Këto fjali mund të riformulohen dhe mund të shtohen të tjera nëse ka nevojë. Merrni copa të letrës me fjalitë më të dobishme dhe ngjitni ato në mur apo në tavolinën tuaj, apo vendosni ato në mënyrë elektronike tek tableti.

<u>Humbja e fokusit të bisedës?</u> Pyetni “çfarë ka tjetër sa i përket [domenit]?”	<u>Shumë i fokusuar në probleme?</u> Pyetni se çfarë po shkon mirë, jo se çfarë po shkon keq!	<u>Shumë i fokusuar në probleme?</u> Rifokusohuni tek zgjidhja!
<u>Humbja e fokusit të bisedës?</u> Fokusohuni tek struktura e aplikacionit!	<u>Pacienti dyshues?</u> Inkurajoni pacientin dhe ndani tabletin me të!	<u>Biseda nuk rrjedh natyrshëm?</u> Sigurohuni që pacienti të mund ta shohë tabletin!
<u>Koha e kufizuar?</u> Kini parasysh ritmin e vlerësimit/diskutimit!	<u>Koha e kufizuar?</u> Mos diskutoni më tepër se 3 domene!	<u>Biseda nuk rrjedh natyrshëm?</u> Mbani kontaktin me sy me pacientin, jo vetëm me tabletin!

Shembuj të citateve nga përvojat pozitive të pacientëve me DIALOG+

Këto citate janë marrë nga faza e pilotimit të studimit IMPULSE.

Shembuj të citateve nga përvojat pozitive të pacientëve me DIALOG+
“Pas sesioneve më është dukur sikur kur e heq një ankth, jemi ndjerë mirë që i kemi shprehur mendimet tona dhe që klinicisti i ka marrë këto mendime ashtu siç i kam shprehur. Jam ndjerë shumë mirë pas përdorimit të D+”
“...fillimisht nuk kam dashur të marr pjesë, dhe pastaj... ka filluar të më pëlqejë shumë biseda dhe pastaj jam ndjerë më mirë, shumë më mirë”
“Përfundimisht kam vendosur që të mos i shtyj më problemet e mija për më vonë dhe i përfundoj gjërat, gjë që më bën shumë të kënaqur.”
“Mendoj që do t’i përshtatetj çdo pacienti.”
“...dhe përparësia ka qenë që përmes DIALOG+ ne kemi mundur t’i zgjidhim shumicën e problemeve tona.”
“Edhe mua më është dukur interesante, i kanë prekur disa tema për të cilat kemi patur nevojë të flasim me dikë dhe nuk kemi mundur të flasim. Kështu që ne e kemi patur një mundësi për të diskutuar me dikë për temat që kemi patur nevojë.”
“Mendoj që D+ na ka ndihmuar shumë, për shkak se na ka bërë të vetëdijshëm për veten, se çfarë mund të bëjmë dhe çfarë duhet të bëjmë. Mendoj që është shumë mirë që D+ na ka ndihmuar shumë. Në një mënyrë na ka lehtësuar jetën.”

Lista e aktiviteteve që lidhen me punën

Lista e aktiviteteve që lidhen me punën në Kosovë:

1. Puna vullnetare
2. Recepcionist
3. Zdrukhtaria
4. Gastronomia
5. Kamarier/kamariere
6. Shërbimet e pastrimit
7. Përkujdesja ndaj kafshëve
8. Kopshtaria
9. Arkatar/Arkatare
10. Logjistikë
11. Punëdore
12. Shtypshkronjë

8. Referenca

1. WHO. Regional Office for Europe 2014; Available from: <http://www.euro.who.int/en/health-topics/noncommunicable-diseases/mental-health>.
2. Priebe S, H.P., Knight S, Evans S., *Application and results of the Manchester Short Assessment of Quality of Life (MANSA)*. The International journal of social psychiatry, 1999. **45**(1): p. 7-12.
3. Phelan M, S.M., Thornicroft G, Dunn G, Holloway F, Wykes T, Strathdee G, Loftus L, McCrone P, Hayward P., *The Camberwell Assessment of Need: the validity and reliability of an instrument to assess the needs of people with severe mental illness*. British Journal of Psychiatry, 1995. **167**(5): p. 589-95.
4. Derogatis, L.R., *BSI Brief Symptom Inventory: Administration, Scoring, and Procedure Manual*. 4th ed. 1993, Minneapolis: MN: National Computer Systems
5. Ventura, J., Lukoff, D., Nuechterlein, K.H., Liberman, R.P., Green, M.F., Shaner, A. , *Manual for the Expanded Brief Psychiatric Rating Scale*. International Journal of Methods in Psychiatric Research 1993(3): p. 177-43.
6. Kring AM, G.R., Blanchard JJ, Horan WP, Reise SP., *The Clinical Assessment Interview for Negative Symptoms (CAINS): final development and validation*. American Journal of Psychiatry, 2013. **170**(2): p. 165-72.
7. Beecham J, K.M., *Costing psychiatric interventions*, in *Measuring Mental Health Needs*, T. G, Editor. 2001, Gaskell: London